



Republika e Kosovës  
Republika Kosova  
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut  
Opština Kaçanik  
Municipal Kaçanik



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E KAÇANIKUT  
OPŠTINA KAÇANIK



1	Data	19.05.26	Vendi	KAÇANIK
	Nj. org.		Numri	Shtojcë
	01		104/02-11672	/.

**DRAFT - RREGULLORE**

**PËR TRANSPORT RRUGOR NË TERRITORIN  
E KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

**Kaçanik, Maj 2026**

Në bazë të nenit 11, 12.2 (c) lidhur me nenin 40.2(a) dhe 17(f) të Ligjit nr. 03/L – 040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28/2008, 04 Qershor 2008), nenit 6 të Ligjit Nr. 04/L-179 për Transportin Rrugor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.21 e datës 13 qershor 2013), të nenit 34.5 lidhur me nenin 6.2 (f) të Statutit të Komunës së Kaçanikut (teksti i spastruar sipas Statutit 01Nr.60/01-12895/20 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Statutit të komunës së Kaçanikut 01Nr.3588/2008), Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e mbajtur më \_\_\_\_\_/2026 të aprovoj këtë:

## **DRAFT - RREGULLORE**

### **PËR TRANSPORTIN RRUGOR NË TERRITORIN E KOMUNËS SË KAÇANIKUT**

#### **DISPOZITAT E PËRGJITHSHME**

##### **Neni 1 Qëllimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është rregullimi dhe zhvillimi i sektorit të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave brenda kufijve administrativ të komunës, qasjen e hapur dhe jo diskriminuese në mes, si dhe ofrimin e shërbimeve në tregun e sektorit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave.
2. Me këtë Rregullore përcaktohen kompetencat e Komunës në rregullimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, procedurave për licencimin e operatorëve në ofrimin e transportit rrugor, certifikimi, llojet transportit, obligimet dhe të drejtat e operatorëve të transportit, mbikëqyrje dhe inspektimi rrugor, gjohet për shkelje të dispozitave të kësaj rregulloreje, si dhe çështje të tjera të cilat lidhen me transportin.
3. Kjo Rregullore rregullon kushtet e qasjes në treg të operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave që përdor të paktën një mjet motorik ose një tërësi mjetesesh pesha e mjetit e të cilëve është mbi tre pikë pesë (3.5) tonë dhe jo më pak se gjashtë (6) tonë pesha e përgjithshme për të kryer transportin e mallërave, ose të paktën me një automjet i cili është teknikisht në gjendje të rregullt, për nga lloji i konstruktimit dhe pajisjeve, me kapacitet me më shumë se tetë plus një (8+1) ulëse, përfshirë edhe ngasësin për të kryer transport të udhëtarëve.

##### **Neni 2 Fusha e zbatimit**

1. Me këtë rregullore, rregullohen kushtet e realizimit të shërbimeve të transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallërave, që kryhen nga operatorët e transportit rrugor në territorin e Komunës së Kaçanikut:
  - 1.1. Lejimi ose ndalimi i përdorimit të autobusëve publik në rrugë të caktuara,
  - 1.2. Marrja dhe zbritja e udhëtarëve dhe çështje tjera lidhur me transportin e udhëtarëve,
  - 1.3. Krijimi dhe mbajtja (ruajtja) e regjistrave dhe inspektimi i tyre,
  - 1.4. Transporti i bagazhit të udhëtarëve ose i mallrave të tjera,
  - 1.5. Rregullimi ose ndalimi i transportit të udhëtarëve që qëndrojnë në këmbë,
  - 1.6. Çështja e pajisjeve dhe mjeteve (të brendshme ose të jashtme) të autobusëve publik,
  - 1.7. Pikat e stacioneve dhe vendndaljet në linjat për autobusë, minibusë dhe kombi bus.
  - 1.8. Rregullimi ose ndalimi i shpalljeve, shenjave dhe reklamave, brenda apo jashtë autobusëve publik.
  - 1.9. Stacionet lokale (vendqëndrimi për autobus, minibus, kombi - bus dhe auto taksi).

### Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet e përdora në këtë rregullore kanë këtë kuptim:
  - 1.1 **Komunë** - njësi themelore territoriale e vetëqeverisjes lokale në Kosovë, e përcaktuar sipas Ligjit përkatës për Vetëqeverisje Lokale;
  - 1.2 **Rrugë publike** - një sipërfaqe me rëndësi të përgjithshme për komunikacion, në të cilën mund të lëvizë çdo kush me kushte të caktuara me ligj dhe të cilën organi kompetent e ka shpall rrugë publike;
  - 1.3 **Operator - taksi** - veprimtari e transportit të udhëtarëve e cila ushtrohet nga personat fizik dhe juridik;
  - 1.4 **Stacion i autobusëve** - objekti me infrastrukturën përcjellëse të licencuar nga Ministria me qëllim të ofrimit të shërbime për operatorët e transportit rrugor të udhëtarëve dhe udhëtarët;
  - 1.5 **Vendndalje** - sipërfaqe e ndërtuar dhe të shënuar posaçërisht, e caktuar për ndaljen e autobusëve e që mundëson hyrjen, përkatësisht daljen e sigurt të udhëtarëve dhe bagazheve;
  - 1.6 **Itinerar** - akti i cili përcakton kahun e lëvizjes së automjeteve në linjë;
  - 1.7 **Lëshues i licencës** - organi i cili sipas dispozitave të këtij ligji është kompetent për lëshimin e licencës;
  - 1.8 **Operator i transportit rrugor të mallrave** - veprimtarinë e çdo operatori transportues të mallrave që kryen transport për nevoja personale dhe palë të tretë, me anë të mjeteve motorike ose të mjeteve të kombinuara;
  - 1.9 **Operator i transportit rrugor të udhëtarëve** - veprimtari e çdo operatori që vepron me anë të mjeteve motorike që janë të përshtatshme për bartjen e më shumë se nëntë personave, përfshirë edhe vozitësin, dhe të destinuara për këtë qëllim, shërbimet e transportit të pasagjerëve për publik ose për kategori të veçanta të përdoruesit në këmbim të pagesës nga personi i transportuar ose nga organizatori transportit;
  - 1.10 **Transport publik** - transport të cilin në kushte të njëjta mund ta shfrytëzojnë të gjithë shfrytëzuesit e shërbimeve të transportit;
  - 1.11 **Transport publik linjor i udhëtarëve** - transporti i cili kryhet në relacionet e caktuara dhe sipas rendit të udhëtimit, çmimeve dhe kushteve të përgjithshme të transportit të përcaktuara paraprakisht;
  - 1.12 **Licencë** - akti me të cilin operatori i transportit rrugor lejohet të ushtrohet veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve ose mallrave, stacionet e autobusëve dhe terminaleve të mallrave;
  - 1.13 **Linjë** - relacioni ose tërësia e relacioneve të kryerjes së transportit në komunikacionin rrugor, prej stacionit fillestar deri në stacionin, përkatësisht deri në vend-ndaljen përfundimtare, në të cilën transportohen udhëtarët sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe të publikuar me një ose me më shumë nisje;
  - 1.14 **Linjë ndër-urbane** - linjë e cila zhvillohet në rrugët publike magjistrale dhe regionale të Kosovës dhe që lidhë dy apo më shumë Komuna;
  - 1.15 **Linjë urbane** - linja e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda kufijve urban të një Komune - qyteti;
  - 1.16 **Linjë urbane-periferike** - linjë e cila i lidh dy e më tepër stacione, gjegjësisht vend ndalje brenda territorit të një Komune;
  - 1.17 **Operator i Transportit** - personi fizik ose juridik, vendor ose të jashtëm i cili posedon licencën për kryerjen e veprimtarisë së transportit në komunikacionin rrugor;
  - 1.18 **Fleturdhëresë e rrugës** - formular i përcaktuar i cili përmban numrin e regjistrimit të autobusit me të cilin kryhet transporti linjor i udhëtarëve, emërtimin e linjës, kohën e fillimit dhe të mbarimit të udhëtimit, të dhënat për personelin e automjetit dhe drejtimin e qarkullimit të tij, nënshkrimin e personit të autorizuar për lëshimin e fletëurdhëresës së rrugës si dhe rubrikën për shënimin e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve ose nga vend ndalja e autobusëve në transportin linjor;

1.19 **Relacion** - distancë ndërmjet dy vendeve të linjës të cilat në rend të udhëtimit janë shënuar si stacione të autobusëve, përkatësisht si vend ndalje të autobusëve;

1.20 **Fletëngarkesë** - akt i cili shoqëron mallin dhe duhet të përmbajë: datën dhe vendin e lëshimit, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e dërguesit, pastaj adresën e tij, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e operatorit të transportit, shenjën e regjistrimit të automjetit, datën dhe vendin e ngarkimit të mallit, emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e marrësit dhe vendin e shkarkimit, shënimin e sasisë dhe të llojit të ngarkesës, listen e dokumenteve që i bashkëngjiten fletëngarkesës, shpenzimet e transportit dhe shpenzimet e tjera;

1.21 **Rendi i udhëtimit** - akt i cili përmban: emërtimin e operatorit të transportit, linjën në të cilën kryhet transporti, llojin e linjës, radhitjen e stacioneve të autobusëve, përkatësisht të vendndaljeve të autobusëve, pastaj distancën nga vendi ku fillon linja, kohën e arritjes dhe të nisjes nga stacioni i autobusëve, përkatësisht në vendndaljet e autobusëve, regjimin e mbajtjes së linjës, periudhën;

1.22 **Tarifë** - akt i cili përmban çmimin lidhur me kryerjen e shërbimeve dhe kushteve tjera transportuese.

#### **Neni 4**

Kjo Rregullore zbatohet në transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në rrugët publike në territorin e komunës së Kaçanikut.

#### **Neni 5**

1. Rregullimin dhe organizimin e transportit rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave në territorin e komunës së Kaçanikut e bën Drejtoria e Emergjencave dhe Shërbimeve Publike (më poshtë D. E. SH. P).

2. Komuna ka kompetencë të certifikoj automjetet me më shumë se tetë plus një (8+1) ulëse për transport urban dhe urbano – periferik.

#### **Neni 6**

1. Kuvendi i Komunës së Kaçanikut (më poshtë Kuvendi), me propozim të DESHP-së:

1.1 Përcakton politikat e zhvillimit të shërbimeve të transportit, të sigurta, efikase dhe ekonomike brenda territorit të Komunës,

1.2 Nxjerr Planin e transportit lokal dhe e ndryshon atë sipas nevojës,

1.3 Ndryshon Planin e transportit, jo më vonë se pesë vjet nga data e nxjerrjes së tij,

1.4 Publikon Planin apo Planin e ndryshuar dhe një kopje të tij ia dërgon Ministrisë së Infrastrukturës.

2. Plani duhet të jetë në përputhshmëri me politikën e zhvillimit të tërësishëm të transportit në Kosovë.

#### **Neni 7**

1. Operatorët e transportit që kryejnë veprimtari transporti në territorin e komunës së Kaçanikut janë të detyruar:

1.1. Të përdorin mjete të transportit që janë teknikisht në gjendje të rregullt,

1.2. Të mbajnë në mënyrë të rregullt regjistrin dhe dokumentet për çdo automjet për veprimtarinë e vet transportuese,

1.3. Të plotësojnë evidenca statistikore sipas formave të miratuara nga organet përkatëse dhe t'i raportojnë ato sipas mënyrës së përcaktuar me ligj,

1.4. Të mbajnë dokumentet përkatëse në automjetet transportuese, të parapara sipas Ligjit për transportin rrugor.

1.5. Gjatë transportit të rregullt të udhëtarëve, operatori është i detyruar që në autobus të ketë edhe këto dokumente: Rendin e Udhëtimit, Licenca - Lejen e punës (Çertifikatën

e automjetit – ekstrakt nga Licenca): fletëurdhëresën e rrugës dhe certifikatën e regjistrimit të automjetit.

1.6. Çertifikata e automjetit është pjesë përbërëse e licencës – Leje e Punës të cilën e lëshon DESHP, duke u bazuar në kriteret e licencimit, në emër të operatorit transportues të udhëtarëve dhe mallrave të cilët janë të licencuar në Komunën e Kaçanikut.

1.7. Çertifikata e automjetit lëshohet për çdo automjet të operatorit transportues e cila është e pa transferueshme dhe e patjetërsueshme dhe është pjesë e licences, dhe në rast të shitjes së automjetit operatori transportues obligohet ta kthejë certifikatën në afat prej 15 ditëve te organi kompetent.

### **Neni 8**

Veprimtaria e transportit rrugor të udhëtarëve dhe mallrave kryhet në bazë të licencës – lejes së punës.

### **Neni 9**

1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve nuk mund të ushtroj veprimtarinë para se të pajiset me Licencë (Leje Pune) dhe Rend të Udhëtimit.

2. Licenca (Leja e punës) është e domosdoshme për këto raste:

- 2.1 Transport të udhëtarëve;
- 2.2 Transport taksi;
- 2.3 Transport të mallrave;
- 2.4 Stacione të autobusëve;

### **Neni 10**

#### **Transporti rrugor i udhëtarëve**

1. Transporti rrugor i udhëtarëve në territorin e komunës ushtrohet si:

- 1.1 Transport i rregullt i udhëtarëve;
- 1.2 Transport i lirë i udhëtarëve;
- 1.3 Transporti taksi i udhëtarëve;
- 1.4. Transport i udhëtarëve për nevoja vetanake.

2. DESHP - ja është përgjegjëse për koordinimin dhe rregullimin e transportit rrugor në territorin e komunës së Kaçanikut.

### **Neni 11**

1. Transporti i rregullt i udhëtarëve me autobusë kryhet në relacione të caktuara (linja) sipas rendit të udhëtimit, të përcaktuar dhe të vërtetuar më parë, çmimit të caktuar, të shpallur dhe kushteve të tjera të transportit.

2. Linjat të cilat lidhin dy e më tepër vendbanime në territorin e komunës, janë linja komunale.

3. Koha mbrojtëse e operatorëve të transportit publik të udhëtarëve me autobus, minibus dhe kombi – taksi (8+1), për çdo nisje, duhet të jetë së paku prej 30 min.

### **Neni 12**

1. D E S H P, miraton rrjetin e linjave urbane dhe urban – periferike dhe numrin e orareve.

2. D E S H P, sipas nevojës dhe kërkesave të qytetarëve dhe të operatorëve të transportit publik, mund të ofroj edhe linja tjera të reja.

2.1. Për linjën e re përparësi kanë operatorët që operojnë në relacionin ekzistues të miratuar paraprakisht.

### Neni 13

#### Kushtet për pajisje me Licencë (Leje Pune) për transport publik të udhëtarëve:

1. Leja e punës për autobusë mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:
  - a) Të ketë në pronësi së paku një (1) autobus për linjë;
  - b) Për çdo linjë, të ketë të punësuar së paku një shofer profesionist të kategorisë “D”,
  - c) Një mekanik për mirëmbajtje, respektivisht kontratën me servisën për mirëmbajtje të autobusëve,
  - d) Biznesin e regjistruar në MTI,
  - e) Selinë e kompanisë në teritorin e komunës sonë,
  - f) Të mos ketë ndalesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë.
  - g) Një (1) minibusë - në terrenet ku nuk mund të operojnë autobusët, për shkak të konfiguracionit të terrenit.Licenca lëshohet në vlefshmëri prej së paku pesë (5) vitesh.
  
2. Leja e punës për operator me kombi bus me 8+1 ulëse do të jepet në linjën në të cilën nuk mund të operoj autobusit dhe minibusi dhe aplikuesi duhet të plotëson këto kritere:
  - a) Të ketë në pronësi së paku një (1) kombi bus për linjë me 8+1 ulëse,
  - b) Të jetë banor i komunës së Kaçanikut,
  - c) Të posedoj patent shoferin më të vjetër se 5 vite,
  - d) Të posedoj certifikatën e regjistrimit të biznesit,
  - e) Të ketë në pronësi automjetin në emër të biznesit;
  - f) Të mos ketë pengesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë.Licenca lëshohet në vlefshmëri prej së paku tre (3) vitesh.
  
3. Leja e punës për taksi veturë (4+1) mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:
  - a) Automjeti të ketë pesë (05) dyer,
  - b) Automjeti të ketë 4+1 ulëse,
  - c) Automjeti të ketë taksimetër (çmimoren për km),
  - d) Të posedoj certifikatën e regjistrimit të biznesit,
  - e) Të posedoj patent shoferin më të vjetër se pesë (05) vite të kategorisë “B”,
  - f) Të jetë pronar i automjetit me të cilin ushtron këtë veprimtari si dhe librezë të jetë në emër të biznesit,
  - g) Automjeti të ketë të vendosur firmën “TAXI” në pjesën e përparme të kulmit të automjetit, e cila duhet të ndiçoj natën,
    - i) Të mos i jetë shqiptuar masa mbrojtëse e ndalimit të kryerjes së transportit taksi të udhëtarëve, më gjatë se gjashtë (6) muaj,
  - 3.2 Personi fizik mund të ushtroj këtë veprimtari vetëm me automjetin e tij personal, të cilin vet e drejton.
  
4. Leja e punës për Kompani Taksi – Operator Taksi, mund të jepet, nëse aplikuesi i plotëson këto kritere:
  - a) Të ketë selinë në teritorin e komunës së Kaçanikut,
  - b) Të ketë certifikatën e regjistrimit të biznesit,
  - c) Të ketë së paku dy (02) automjete në pronësi,
  - d) Automjetet të kenë taksimetër (çmimoren për km),
  - e) Të gjithë shoferët e punësuar, të posedojnë patent shoferin më të vjetër se pesë (05) vite,
  - f) Të mos ketë ndalesa juridike për ushtrimin e veprimtarisë,
  - g) Të ketë vendparkim, frekuenca, zyrë, lidhje telefonike dhe kontratën apo servisën për mirëmbajtje të automjeteve.Licenca lëshohet në vlefshmëri prej së paku një (1) viti.

5. Dispozita e nën paragrafit 1 të pikës (f), 2 të pikës (f), 3 të pikës (i), 4 të pikës (f) të këtij neni nuk do të aplikohet nëse kanë kaluar pesë (5) vjet nga dita e skadimit të ndalesës.

#### **Neni 14**

Licencat për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të udhëtarëve, mallrave dhe stacioneve të autobusëve, jepen kundrejt pagesës që parasheh Rregullorja e Komunës për Taksa, Tarifa dhe Ngarkesa Komunale.

#### **Neni 15**

##### **Revokimi i licences**

1. Operatori të drejtën e licencës për veprimtarinë e transportit rrugor dhe të mallrave mund ta humbë kur:
  - 1.1 Operatori falimenton dhe vërtetohet me vendim të autoriteteve kompetente;
  - 1.2 Mbaron afati i vlefshmërisë së licencës, dhe
  - 1.3 Kërkohet nga mbajtësi i saj që të ndërpres të drejtën në licencë;
2. Licenca apo leja për veprimtarinë e transportit revokohet nga organi që e lëshohet atëherë kur:
  - 2.1 Vërtetohet se operatori ka humbur njërin nga kushtet e përcaktuar për qasjen në treg të operatorëve të transportit rrugor dhe të mallrave të përcaktuara në nenin 8 të këtij akti;
  - 2.2 Mbajtësi i licencës apo lejes shkel detyrimet e përcaktuara në këtë rregullore dhe aktet tjera ligjore.
3. Licenca për veprimtarinë e transportit i hiqet në mënyrë të përhershme nga organi kompetent, operatori që është dënuar nga gjykata kompetente për kryerjen e vepres penale për kontrabandë me narkotik dhe trafikim me qenie njerëzore.
4. Propozimin për iniciimin e procedurës për revokimin e licencës sipas paragrafit 2 dhe 3 të këtij neni e bënë Inspektorati i Komunës.
5. Vendimi merret nga organi që e ka lëshuar atë, pas dëshmisë së provave dhe argumentimit nga inspektorë të transportit rrugor pran Komunës.

#### **Neni 16**

##### **Rendi i Udhëtimit (R.U)**

1. Rendi i udhëtimit është akt me të cilin përcaktohen elementet për ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt në transportin rrugor, në territorin e komunës, i cili përmban:
  - 1.1 Emrin e operatorit;
  - 1.2 Relacionin;
  - 1.3 Llojin e transportit;
  - 1.4 Radhitjen e vend - ndaljeve dhe largësinë e tyre nga pika fillestare në km
  - 1.5 Kohën e nisjes dhe kohën e arritjes në çdo stacion dhe vend - ndalje;
  - 1.6 Ditët e operimit, periudhën kohore në të cilën mbahet linja;
  - 1.7 Afatin e vlefshmërisë së rendit të udhëtimit.
2. Rendi i Udhëtimit (R.U) vlen tri (3) vite.

#### **Neni 17**

##### **Fillimi i veprimtarisë në transportin rrugor të udhëtarëve me autobusë dhe Kombi bus 8+1 ulëse**

1. Operatori i transportit publik të udhëtarëve me autobus, minibus dhe kombi bus, është i obliguar që transportin ta kryej në mënyrë të rregullt dhe sipas rendit të udhëtimit, të vërtetuar dhe të regjistruar në D E SH P.

2. Operatori transportues, duhet ta filloj veprimtarinë e transportit të rregullt publik të udhëtarëve në afat prej tri (3) ditësh nga dita e fuqizimit të rendit të udhëtimit dhe atë nuk mund ta ndërpres përderisa zgjat afati i rendit të udhëtimit.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 1. i këtij neni, operatori transportues mundet përkohësisht të ndërpres veprimtarinë si rezultat i kushteve të jashtëzakonshme të cilat e pamundësojnë ushtrimin e veprimtarisë së transportit të rregullt urban dhe urban - periferik.
4. Për ndërprerjen, nga paragrafi 2 i këtij neni, operatori transportues është i obliguar që të informoj D E SH P-në, e cila ka vërtetuar Rendin e Udhëtimit dhe e cila do të lëshoj një vendim për pranim apo refuzim të kërkesës së transportuesit.
5. Operatori transportues nuk mundet ta ndërpret (pezulloj) veprimtarinë e transportit të rregullt të udhëtarëve në linjë sipas rendit të udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar, pa lejen e organit që e ka lëshuar atë rend të udhëtimit.
6. Rendi i udhëtimit nuk mund të tjetërsohet, transferohet dhe as të jepet me qira.
7. Emri i operatorit transportues, i shënuar në rendin e udhëtimit, duhet të jetë i njëjtë me atë të shënuar në certifikatën e regjistrimit të automjetit (CRA) dhe në dokumentet tjera përcjellëse të autobusit.

#### **Neni 18**

#### **Revokimi i Rendit të Udhëtimit (R.U)**

1. Rendi i udhëtimit do të revokohet nga organi që e ka lëshuar atë në rastet kur:
2. Në afat prej tri (3) ditësh nga dita e fuqizimit nuk ia fillon veprimtarisë;
3. Brenda një (1) muaji kalendarik pa miratimin e organit që i ka lëshuar atë nuk e mban nisjen tri (3) herë.
4. Bën ndërprerje të kohëpaskohshme të mbajtjes së nisjes sipas Rendit të Udhëtimit, respektivisht 12 herë brenda vitit kalendarik, pa miratimin e D E SH P-së.
5. Kur operatori vepron në kundërshtim me këtë Rregullore dhe në kundërshtim me Ligjin për Transportin Rrugor.

#### **Neni 19**

#### **Shpallja e nisjeve të lira**

1. Linjat dhe nisjet e revokuara do të konsiderohen si të lira dhe të njëjtat i nënshtrohen procedurës për ndarjen e tyre.
2. Drejtoria me akte nënligjore do të përcakton kushtet, kriteret, procedurat dhe tarifat për shpalljen e nisjeve të lira.
3. Nuk i lejohet ri aplikimi operatorit për të njëjtën linjë që ka hequr dorë njëherë.

#### **Neni 20**

#### **Çmimorja**

1. Operatori Transportues përcakton çmimoren. Çmimorja duhet të vërtetohet nga DESHP- ja. Çmimorja duhet të vendoset në autobusin që qarkullon në atë linjë.
2. Personeli i autobusit merr pagesën për shërbime vetëm në bazë të çmimores, nga pika 1 e këtij neni.
3. Përjashtimisht nga paragrafi 2 i këtij neni, pagesa mund të bëhet edhe me mujore, me kusht që mujorja të shënohet (vërtetohet) për ç' do udhëtim të shfrytëzuar.

#### **Neni 21**

#### **Biletat**

1. Çdo udhëtar duhet të pajiset me biletë në relacion të caktuar:
  - 1.1. për transportin urban dhe urban periferik biletat mund të blihet në autobus dhe stacion të autobusëve;

2. Udhëtari në automjet ka për detyrë ta tregoj biletën e udhëtimit me kërkesën e personit të autorizuar nga operatori i transportit, respektivisht nga inspektori i komunikacionit rrugorë.
3. Bileta duhet të përmbajë:
  - 3.1. Relacionin;
  - 3.2. Çmimin;
  - 3.3. Numrin serik;
  - 3.4. Emrin e operatorit të transportit;
  - 3.5. Datën dhe kohën e nisjes;
  - 3.6. Dëshmi për bagazhin e udhëtarit.

## **Neni 22**

### **Transporti i veçantë**

1. Transport i veçantë i udhëtarëve është transporti i grupeve të caktuara të udhëtarëve, duke përjashtuar udhëtarët tjerë, në relacion të caktuar dhe në bazë të lejes së veçantë.
2. Me transport të veçantë të udhëtarëve kryhet transporti:
  - 2.1. Nxënësve dhe studentëve nga vendbanimi deri të shkolla dhe anasjelltas,
  - 2.2. Punëtorëve nga vendbanimi deri në punë dhe anasjelltas,
  - 2.3. Invalidëve dhe personave me përkujdesje të veçantë.
3. Lejen për transport të veçantë e lëshon D E SH P, nëse transporti kryhet brenda komunës dhe në bazë të kontratës e cila duhet të ketë:
  - 3.1 Relacionin,
  - 3.2 Listën e udhëtarëve,
  - 3.3 Çmimin e transportit,
  - 3.4 Vendet për marrje dhe zbritje të udhëtarëve dhe
  - 3.5. Kohën, gjatë së cilës kryhet transporti.
4. Në autobus, në pjesën e përparme, në vend të dukshëm, duhet të jetë mbishkrimi "Transport i veçantë".

## **Neni 23**

### **Transporti për nevoja vetanake**

1. Operatori transportues, personi tjetër juridik ose fizik dhe qytetari i cili ka automjetin transportues, mund të kryej transport për nevoja vetanake dhe atë transportin e punëtorëve të vet, ose personave tjerë që kanë të bëjnë me kryerjen e veprimtarisë së vet si dhe transportin e anëtarëve të familjeve të punëtorëve kur shkojnë në pushim apo rekreacion.
2. Transport i udhëtarëve për nevoja personale, në kuptim të kësaj Rregulloreje, konsiderohet edhe transporti i personave të cilin e bëjnë:
  - 2.1 Ndërmarrjet hoteliere, personat tjerë juridik dhe fizik të cilët kryejnë veprimtari hoteliere,
  - 2.2 Institucionet shëndetësore si dhe ato të mbrojtjes sociale që bartin të sëmurit,
  - 2.3 Agjencitë turistike, personat tjerë juridik e fizik të cilët kryejnë veprimtari turistike ku në bazë të kontratës së veçantë të transportit, transportojnë grupe turistësh pa pranimin dhe zbritjen e udhëtarëve gjatë rrugës,
  - 2.4 Shoqatat kulturore, sportive dhe shoqatat tjera që transportojnë nxënës, studentë, personel mësimor ose anëtarë të vet,
  - 2.5 Operatorët transportues ose punëtorët të cilët kryejnë shërbime të veçanta,
3. Veprimtaria e transportit për nevoja vetanake i nënshtrohet marrjes së një autorizimi/çertifikate, varësisht nga kompetencat që ushtrojnë në bazë të ligjit.

## Neni 24

1. Në autobusin me të cilin kryhet transporti për nevojat vetanake, duhet të jetë i plotësuar regjistri i punëtorëve ose i personave tjerë, i vërtetuar nga pronari (transportuesi), ose ndonjë dëshmi tjetër për të drejtën e transportit të këtyre punëtorëve ose personave.
2. Në këndin e djathtë, të poshtëm, të xhamit mbrojtës të autobusit me të cilin kryhet transporti i udhëtarëve për nevoja personale, vendoset mbishkrimi "Transport për nevoja vetanake".

## Neni 25

### Kushtet për rregullësin e automjeteve të transportit publik të udhëtarëve

- 1.1. Të gjithë autobusët dhe kombi busët me të cilët kryhet transporti publik urban dhe urban – periferik i udhëtarëve, duhet të jenë të regjistruar dhe teknikisht në rregull, si dhe të kenë kontroll teknike periodike për 6 (gjashtë) muaj.
- 1.2. Automjetet duhet të kenë fletëurdhëresë e rrugës, të nënshkruar dhe të plotësuar në mënyrë të rregullt.
- 1.3. Shoferit të kenë patent shoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjë;
- 1.4. Shefori duhet të jetë i paisur me certifikat të mjekut të vlefshme 5 vite.
2. Autobusi me të cilin kryhet transporti publik urban dhe urban – periferik, duhet:
  - 2.1 Të vënë firmën, respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore, mbishkrim të madhësisë 20 cm.
  - 2.2 Numrin e linjës me kohën e nisjes dhe kohën e arritjes, ose intervalin e lëvizjes në stacionin e fundit, të vënë në këndin e poshtëm të djathtë të xhamit mbrojtës,
  - 2.3 Orarin e udhëtimit dhe çmimoren e transportit, t'i vënë në vend të dukshëm dhe mbishkrimin për ndalimin e pirjes së duhanit,
  - 2.4 Autobusi duhet t'i mundësoj qasje personave me aftësi të kufizuara.
  - 2.5 Në automjet transportues të udhëtarëve duhet të ketë aparatën për fikjen e zjarrit funksional, çekiçat për thyerjen e xhamave, barnatore manuale, pajisjet rezervë.
3. Automjeti transportues nuk mund të ketë më shumë ulëse se sa i ka të shënuar në certifikatën e regjistrimit të automjetit - CRA
4. Autobusi duhet t'i plotësoj të gjitha kushtet higjieno - teknike të përcaktuara me ligj.
5. Në pjesën e brendshme të automjeteve duhet të vendosen mbishkrimet e rëndësishme për rendin në automjet, ulëset për kategoritë e veçanta të udhëtarëve, shenjat e dymëve të hyrjes dhe të daljes.
6. Në automjetet e transportit rrugor të udhëtarëve ndalohet vendosja e fotografive dhe objekteve të tjera me karakter pornografik.
7. Kur autobusi nuk bën transportin e rregullt të udhëtarëve, në këndin e majtë të xhamit mbrojtës vihet mbishkrimi përkatës "Garazh" apo "Defekt".
8. Në sezonin e dimrit, para daljes në mbajtje të linjës, autobusi duhet të ngrohet.

## Neni 26

Operatori i transportit nuk mund të ketë udhëtarë në automjet më tepër se sa të shënuar certifikatën e regjistrimit të automjetit - CRA.

## Neni 27

1. Drejtuesi i automjetit nuk mund të nis automjetin para se të ketë vërtetuar se janë mbyllur dyert e hyrjes dhe të daljes.
2. Derisa automjeti është në lëvizje, dyert duhet patjetër të jenë të mbyllura.

## Neni 28

1. Udhëtari mund të futë në automjet bagazhin e dorës, karrocën e mbledhur të fëmijëve, pushkën e gjahut ose të sportit me këllëf, skitë dhe kompletin për peshkim.
2. Në automjet, në pjesën ndihmëse, mund të futen qentë zyrtarë dhe qentë ciceron të personave të verbër, me shportë në turi.

## Neni 29

1. Në rast të ndërprerjes së trafikut apo prishjes së automjetit, personeli është i detyruar që udhëtarëve t'ua sigurojë daljen e sigurt nga automjeti.
2. Në rastet e prishjes së automjetit, nga paragrafi paraprak, transportuesi detyrohet që udhëtarëve t'ua mundësojë që me të njëjtat bileta të vazhdojnë udhëtimin me automjet tjetër.

## Neni 30

### Gjatë transportit, ndalohe:

1. Të pengohet personeli i automjetit në kryerjen e detyrës,
2. Pirja e duhanit në automjet,
3. Futja e kafshëve në automjet, përveç në rastet nga neni 28 paragrafi 2) i kësaj Rregulloreje,
4. Hyrja në automjet me armë, përveç personave të autorizuar,
5. Futja në automjet e sendeve të cilat mund të lëndojnë, dëmtojnë, ndotin, shqetësojnë udhëtarët ose dëmtojnë automjetin,
6. Futja në automjet e materialeve ndezëse dhe e mjeteve eksplozive,
7. Hyrja në automjet në gjendje të dehur,
8. Shqetësimi i udhëtarëve me këndim, me muzikë, me britmë, me shprehje e dhe sjellje të papërgjegjshme,
9. Hedhja e mbeturinave dhe pështymja në automjet,
10. Hyrja në automjet pas vërejtjes së personelit se nuk ka vende të lira.
11. Udhëtari i cili edhe pas vërejtjes, kryen ndonjëherë nga veprimet nga ky nen, do të largohet nga automjeti.

## Neni 31

Linjat e përhershme të transportit publik urban dhe urbano - periferik të udhëtarëve hapen në përputhje me Planin e transportit lokal.

## Neni 32

### Transporti taksi i udhëtarëve

1. Rregullimin dhe organizimin e transportit taksi të udhëtarëve e bën D E SH P, në përputhje me nevojat për transport dhe me zhvillimin e planifikuar të Komunës së Kaçanikut.
2. Vendqëndrimi i automjeteve taksi është sipërfaqe e trafikut, destinuar për qëndrimin e automjeteve taksi gjatë punës së drejtuesve të tyre.
3. Vendqëndrimi i automjeteve taksi shënohet me shenja horizontale dhe ato vertikale të trafikut, në shenjat vertikale shënohet emri, numri i vendqëndrimit dhe numri i vendeve.
4. Në vendqëndrime nuk duhet të ketë më shumë automjete se që ka vende të shënuara për automjete taksi.
5. Për mirëmbajtjen e vendqëndrimeve të automjeteve taksi, vendosjen dhe mirëmbajtjen e shenjave të trafikut, kujdeset DESHP.

### **Neni 33**

Transporti taksi është transport publik i personave në transportin jo të rregullt (jashtë linjor) rrugor, për të cilin çmimi për rrugën e kaluar është që më parë i njohur dhe përcaktohet në bazë të taksimetrit, ose sipas çmimoreve të shërbimeve.

### **Neni 34**

1. Transporti taksi i udhëtarëve kryhet vetëm me automjetet me pesë (4+1) ulëse dhe i cili ka së paku katër dyer.
2. Automjeti, sipas paragrafit 1 të këtij neni, nuk mund të ketë mjet për bartje (rimorkio).

### **Neni 35**

1. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve pa licencën dhe pa lejen e lëshuar nga organi kompetent.
2. Numrin e licencave dhe kushtet për licencim për transportuesit taksi të udhëtarëve në territorin e komunës si dhe lejen për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve e lëshon DESHP.

### **Neni 36**

#### **Ndërprerja e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve**

Drejtuesi i taksisë e ndërpret veprimtarinë:

1. Me kërkesë për ç' regjistrim për kryerjen e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve,
2. Me skadimin e afatit të lejes së punës,
3. Me rastin e vdekjes së taksistit,
4. Kur humbet ndonjëra nga kushtet e parapara me ligj dhe me këtë rregullore për marrjen e lejes (licencës).

### **Neni 37**

1. Drejtuesi i auto taksisë detyrohet që në rast të ndërprerjes së veprimtarisë (neni 36 ), t'i kthejë lejen për ushtrimin e kësaj veprimtarie DESHP-së.
2. Veprimtaria e operatorit për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve ndërpritet me fshirjen nga regjistri.

### **Neni 38**

#### **Automjeti për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve**

1. Automjeti për kryerjen e transportit taksi të udhëtarëve (këtu e tutje: automjeti taksi), pos kushteve të përcaktuara me ligj, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:
  - 1.1. të ketë më së shumti pesë (5) ulëse, duke llogaritur edhe ulësen e drejtuesit të automjetit,
  - 1.2. Të ketë së paku katër (4) dyer,
  - 1.3. Të ketë taksimetrit në gjendje të rregullt teknike, të atestuar dhe të vulosur sipas kushteve të përcaktuara për taksimetër, dhe i vendosur ashtu që shuma e parave të regjistruara të jetë e dukshme për udhëtarin sipas çmimorës së shërbimeve,
  - 1.4. Ngrohja dhe ajrosja teknikiisht të jenë në rregull.
  - 1.5. Të ketë shenjën "TAXI" ose "RADIO-TAXI", të vendosur mbi automjetet dhe natën të ndriçuar,

- 1.6. Automjeti të jetë i pastër dhe pa dëmtime,
  - 1.7. Reklammat dhe shenjat e ndryshme (nëse i ka) të mos jenë mbi sipërfaqen e xhamave në pjesën e përparme dhe të prapme të automjetit si dhe xhamat të mos jenë të ngjyrosur,
  - 1.8. Të ketë aparatën kundër zjarrit, të përforcuar në vend të dukshëm dhe të përshtatshëm,
  - 1.9. Të ketë librin e faturave të destinuar për taksi - shërbime, me kopje,
  - 1.10. Automjeti duhet të jetë i regjistruar dhe teknikisht në rregull për transportin e udhëtarëve dhe kontrolli teknik të bëhet çdo 6 muaj.
  - 1.11. Shoferit të kenë patent shoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjë;
  - 1.12. Shefori duhet të jetë i paisur me certifikat të mjekut të vlefshme 5 vite;
  - 1.13. Përveç kushteve të parapara me këtë rregullore, automjetet taksi të operatorëve në mes duhet të ketë shënuar emrin e firmës.
2. Shenja "TAXI" dhe shenja "RADIO TAXI", duhet të jetë e madhësisë 500x120x80 milimetra, me ngjyrë të verdhë dhe shkronja të zeza, me emblemë të Komunës Kaçanik.

### Neni 39

Me automjet taksi nuk mund të transportohen:

1. Personat nën ndikimin e alkoolit apo drogës dhe personat e sëmurë me sëmundje ngjitëse,
2. Fëmijët nën moshën gjashtë vjeçare pa përcjellës.
3. Kufomat,
4. Materialet: eksploduese, radioaktive, helmuese, infektive, ato që ndizen lehtë dhe materiale të tjera, të cilat për shkak të vetive të veta, mund të jenë të rrezikshme për sigurinë dhe shëndetin e udhëtarëve, apo mund të shkaktojnë dëmtime të tjera.

### Neni 40

1. Pronari i automjetit taksi i cili nuk ka leje për ushtrimin e veprimtarisë së transportit taksi të udhëtarëve apo shenjën "Taxi", përkatësisht "Radio-Taxi", do të përjashtohet nga trafiku, nga inspektori i Komunikacionit rrugor, përkatësisht nga zyrtari i autorizuar i policisë, ashtu që do t'i merret librezja e qarkullimit dhe targat e automjetit, në kohëzgjatje prej 48 orësh, deri në 5 (pesë) ditë.
2. Vendimi për përjashtimin e automjetit taksi nga trafiku i dorëzohet drejtuesit, aty për aty. Pasojat dhe shpenzimet e krijuara për shkak të aplikimit të dispozitës nga paragrafi paraprak i këtij neni, në tërësi i bartë pronari i automjetit, përkatësisht drejtuesi.
3. Kur drejtuesi i automjetit taksi nuk kryen transportin taksi të udhëtarëve, përkatësisht kur përdor automjetin taksi për nevoja të veta, është i obliguar që nga kulmi i automjetit të largoj shenjën "TAXI" apo "RADIO-TAXI".
4. Automjetet taxi, të regjistruara për transportin taksi të udhëtarëve në territorin e komunave të tjera, mund të kryejnë transportin e udhëtarëve në territorin e komunës së Kaçanikut në rastin kur sjellin udhëtarë nga komunat tjera, por në kthim nuk guxojnë të marrin udhëtarë të rinj, ndërkaq vetëm mund t'i kthejnë udhëtarët që i kanë sjellë.
5. Me automjet taksi nuk mund të transportohet numër më i madh i udhëtarëve nga numri i ulëseve të regjistruara në automjet, e as që mund të vendoset më vonë numër më i madh i ulëseve nga ato të regjistruara.
6. Drejtuesi i automjetit taksi nuk guxon të qëndroj e as të marr udhëtarë në vendqëndrimet për transportin publik të udhëtarëve
7. Në vendqëndrimet e automjeteve taksi, automjetet vendosen sipas rendit të ardhjes dhe nuk guxon të ketë më shumë automjete se që ka vende të shënuara për automjete taksi.
8. Drejtuesi i automjetit taksi nuk guxon të ofroj shërbime të transportit personalisht apo përmes ndërmjetësuesit dhe të filloj transportin jashtë vendqëndrimit të automjeteve taksi.

#### **Neni 41**

##### **Stacionet e autobusëve**

Stacioni i autobusëve është objekti me infrastrukturën e saj përcjellëse për pranimin dhe përcjelljen e autobusëve sipas rendit të udhëtimit, hyrjen dhe zbritjen e udhëtarëve, shitjes dhe rezervimin e biletave për udhëtar, gardërobën, pajisjen për informimin e udhëtarëve dhe operatorëve të transportit si dhe shërbimet tjera që kanë të bëjnë me transportin e udhëtarëve dhe operatorit e transportit rrugor.

#### **Neni 42**

##### **Kategorizimi i stacioneve të autobusëve**

1. Stacioni i autobusëve nën kushte të barabarta iu ofron shërbime të gjithë operatorëve transportues që kanë rendin e udhëtimit, lejen për transport të regjistruar dhe vërtetuar në Ministrinë përkatëse për transport apo Komunë sipas tarifës të përcaktuar nga Komuna përkatëse e bazuar në kategorinë e stacionit të autobusëve.
2. Personat zyrtar të stacionit të autobusëve janë të detyruar që në vend të dukshëm të mbajnë kartelën identifikues.

#### **Neni 43**

##### **Detyrimet e stacioneve të autobusëve**

1. Stacioni i autobusëve nuk ofron shërbime për operatorët e transportit të cilët nuk kanë rendin e udhëtimit të regjistruar dhe vërtetuar nga Komuna nëse është fjala për transport urban dhe urbano- periferik,
2. Stacioni i autobusëve duhet të ketë mbishkrimin "Stacioni i autobusëve" si dhe emërtimin e vendit ku gjendet stacioni,
3. Personeli i stacionit të autobusëve është i detyruar që të mbajë librin e evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve për linjat urbane dhe urbane periferike dhe për të njëjtën gjë të raportoj në Komunë në periudha tre (3) mujore,
4. Libri i evidencës mbi hyrjen dhe daljen e autobusëve duhet të ketë këto të dhëna:
  - 4.1. Emrin e operatorit të transportit;
  - 4.2. Emrin e linjës sipas rendit të udhëtimit;
  - 4.3. Koha e nisjes dhe e ardhjes së autobusit;
  - 4.4. Targat e regjistrimit të automjetit;
  - 4.5. Fleturdhëresën e rrugës (Nr. Serik),
5. Me hyrjen në fuqi të rendit të udhëtimit, stacioni i autobusëve është i detyruar të bëjë sistematizimin e të gjitha rendeve të udhëtimit sipas relacioneve, kohën e nisjes së autobusit nga stacioni i tij,
6. Licencën për stacionet për kryerjen e veprimtarisë së shërbimeve të transportit urban dhe urbano- periferik e lëshon Komuna.

#### **Neni 44**

##### **Detyrimet tjera për stacionin e autobusëve**

1. Stacionet dhe vend-ndaljet e autobusëve në linjat e përhershme i cakton me plan Drejtoria.
2. Stacionet dhe vend-ndaljet në linjat urbane dhe urbano-periferike duhet të jenë të rregulluara dhe të shënuara, të kenë sipërfaqe përkatëse të trafikut për ndaljen e automjetit, sipërfaqen për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve dhe shenjat e stacionit.
3. Në rrugët publike, sipërfaqja për ndaljen e automjetit parimisht duhet të jetë e ndërtuar jashtë shiritit të rrugës në pjesë të ndarë të rrugës.
4. Sipërfaqja e cila shfrytëzohet për hyrjen dhe daljen e udhëtarëve nga automjeti, në rrugë apo në vendbanim, duhet të jetë e shtruar me asfalt, pllaka ose e betonuar.
5. Stacioni apo vend-ndalja në linjat në të cilat intervali i qarkullimit është më i gjatë se 15 minuta

duhet të kenë nën pullazet.

#### **Neni 45** **Mirëmbajtja**

1. Për rregullimin e stacioneve dhe vend-ndaljeve, mirëmbajtjen dhe vendosjen e shenjave kujdeset Drejtoria.
2. Drejtoria mund të bënë shkëputjen ose transferimin e stacionit dhe të vend-ndaljes, nëse kjo është në interes të organizimit më të mirë dhe sigurisë në trafik.

#### **Neni 46** **Rendi në stacione, vendndalje dhe në automjet**

1. Automjetet patjetër ndalen në të gjitha stacionet, përkatësisht vendndaljet e linjave të tyre.
2. Nëse automjeti nuk ka vende të lira, personeli i automjetit ka për detyrë të njoftoj udhëtarët për këtë.

#### **Neni 47**

1. Sinjalin për nisjen dhe ndaljen e automjetit e jep personeli i automjetit.
2. Vetëm personeli i automjetit hap dhe mbyll dyert e automjetit.
3. Personeli i automjetit nuk guxon të jap shenjë për nisje deri sa të konstatoj se janë mbyllur dyert për hyrje dhe për dalje të udhëtarëve.

#### **Neni 48**

1. Hyrja dhe dalja e udhëtarëve behët vetëm në stacionet e autobusëve dhe në vendndaljet e destinuara dhe të regjistruara në rendin e udhëtimit dhe me Plan të Transportit Publik.
2. Operatorët e transportit Publik të udhëtarëve nuk ju lejohet të ndalen në rrugë dhe të kryejn shërbime në hyrjen dhe daljen e udhëtarëve jashtë stacionit të Autobusëve dhe vendndaljeve e autobusëve.
3. Transportuesi është i obliguar të ndalet në të gjitha vendndaljet të cilat i ka të regjistruara në rendin e udhëtimit.

#### **Neni 49**

Personeli i automjetit ka për detyrë që gjatë orarit të punës të mbajë rrobat (uniformën) zyrtare ose kartelen identifikuese dhe ndaj udhëtarëve të ketë sjellje korrekte.

#### **Neni 50**

1. Udhëtarët hyjnë në automjet në dyert e shënuara për hyrje dhe zbresin në dyert e shënuara për dalje.
2. Personat me aftësi të kufizuara, gratë shtatzëna, personat me fëmijë deri në 5 vjeç, inspektorët e trafikut, policët në uniformë dhe personat me autorizime të veçanta, mund të hyjnë në dyert e daljes.

#### **Neni 51**

1. Për shfrytëzimin e shërbimeve të transportit, udhëtari duhet të ketë biletën e udhëtimit, biletën e parapagimit apo leje tjetër valide të udhëtimit.
2. Udhëtari është i obliguar që me kërkesën e personit të autorizuar, të tregoj biletën përkatëse të udhëtimit.

## Neni 52

Transportuesi në trafikun publik urban dhe urbano - periferik të udhëtarëve, është i obliguar që të jap biletën e udhëtimit, në bazë të së cilës udhëtari fiton të drejtën për udhëtim si dhe biletën e bagazhit, nëse paguhet kompensim i veçantë për të.

## Neni 53

1. Udhëtari i cili është gjetur, përkatësisht që gjendet pa biletë udhëtimi në automjet, është i obliguar që me kërkesë të personit të autorizuar, të bëj kompensimin e biletës dhe gjobën në lartësi të dhjetëfishit të çmimit të biletës.

2. Nëse udhëtari refuzon të bëj pagesën, nga paragrafi paraprak, detyrohet që personit të autorizuar t'i jap të dhënat e sakta për identitetin e vet.

## Neni 54

Drejtuesi i automjetit është i obliguar të respektoj itinerarin e linjës, të cilin duhet t'a ketë në automjet.

## Neni 55

Drejtuesi i automjetit në transportin linjor të udhëtarëve nuk mund të ndalë – parkoj automjetin në stacionin e nisjes dhe në peronim, më gjatë se 20 minuta.

## Neni 56

### Transporti rrugor i mallrave

1. Transporti rrugor i mallrave (më poshtë i quajtur: transporti i mallrave) kryhet si:
  - 1.1. Transporti i mallrave për nevoja personale,
  - 1.2. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë, si dhe
  - 1.3. Transporti i mallrave për bartjen e mjeteve (shërbimi Marimangë).
2. Operatori i transportit të mallrave, tek i cili kapaciteti i automjetit e tejkalon peshën e vetanake mbi 3.5 t me fushëveprim mbrenda territorit të Komunës Kaçanik është kompetent organi komunal për licencim.
  - 2.1. Për ushtrimin e kësaj veprimtarie të transportit të mallrave, operatori apo personi fizik që transportin e shfrytëzon për nevoja personale, me qira dhe pagesë si dhe bartje të mjeteve duhet të pajiset edhe me leje komunale për mjetet e transportit që e tejkalon peshën vetanake mbi 3.5 t.
  - 2.2. Kriteret për leje komunale i përcakton DSHPE-ja për Komunën e Kaçanikut.
3. Gjatë transportit të mallrave, operatori në automjet duhet t'i ketë këto dokumente:
  - 3.1. licencën – Leje Pune (Çertifikatën e automjetit – ekstrakt nga Licenca);
  - 3.2. fleturdhëresë;
  - 3.3. shoferit të kenë patent shoferin e kategorisë përkatëse për drejtimin e automjetit gjegjës;
  - 3.4. shoferi duhet të jetë i paisur me çertifikat të mjekut të vlefshme 5 vite;
  - 3.5. shoferi të jenë punëtorë i regjistruar te operatori;
  - 3.6. transportuesit të ketë të shënuar emrin e firmes në çertifikatën e regjistrimit të automjetit (CRA), si dhe në dokumentet tjera përcjellëse, respektivisht emërtimin e transportuesit, në pjesën anësore me mbishkrim të madhësisë 20 cm, si dhe paisjet rezervë të automjetit;

3.7. automjeti të jenë i regjistruar dhe teknikisht në rregull, si dhe të kenë kontroll teknike periodike për 6 (gjashtë) muaj,

3.8. Automjeti të jetë i dedikuar për bartjen e mjeteve (shërbimi Marimangë), të këtë dritë rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet dhe të këtë shenja përkatëse të komunikacionit.

#### **Neni 57**

#### **Kushtet dhe kriteret për licencim të operatorëve të transportit rrugor të mallrave**

1. Për marrjen e licencës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të mallrave, operatori duhet të plotësojë këto kushte:
  - 1.1. Të jetë i regjistruar për shërbim përkatës (çertifikata e regjistrimit të biznesi);
  - 1.2. Selia e kompanisë të jetë në territorin e Komunës së Kaçanikut;
  - 1.3. Të ketë reputacion të mirë;
  - 1.4. Të mos ketë pengesa juridike për zhvillim të veprimtarisë;
  - 1.5. Të ketë automjetet e transportit në gjendje të mirë teknike-eksploatuese.
  - 1.6. Listën më të dhënat e mjeteve transportues,
  - 1.7. Shefëri duhet të jetë i paisur me çertifikat të mjekut të vlefshme 5 vite, si dhe
2. Për bartjen e automjeteve (shërbimin Marimangë) të këtë edhe:
  - 2.1. Së paku dy (2) automjete për bartje, së paku dhjetë (10) bllokues rrotash,
  - 2.2. Të ketë sistem funksional të komunikimit, me shërbimin 24/7 në javë; me numër të mjaftueshëm të personelit për ushtrimin e veprimtarisë;
  - 2.3. Të ketë vendparkimin për vendosjen e automjeteve (të dëshmuar me fletë poseduese ose kontratë mbi shfrytëzimin).
3. Licencat për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor të mallrave jepen kundrejt pagesës që parasheh Rregullorja e Komunës për Taksa dhe Tarifa Komunale.

#### **Neni 58**

#### **Transporti i mallrave për nevoja vetanake**

1. Ndalohet marrja me transport për nevoja vetanake, pa qenë i regjistruar si transportues për këtë.
2. Dispozita e pikës paraprake nuk do të zbatohet mbi mbajtësin e licencës për transport të mallrave me qira.

#### **Neni 59**

1. Emri dhe natyra e biznesit duhet të deklarohen kur të regjistrohet veprimtaria e transportit të mallrave për nevoja vetanake.
2. Regjistrimi nuk do të jetë i efektshëm derisa aplikuesi të tregoj se transporti i mallrave për të cilin është kërkuar regjistrimi, mund të emërohet si transport i mallrave për nevoja vetanake.

#### **Neni 60**

1. Me rastin e kryerjes së transportit për nevoja vetanake me automjeti mbi 3,5 tonelata të një mase më të madhe të lejuar, në automjet duhet të këtë:
  - 1.1 fletëngarkesën dhe
  - 1.2 dëshminë nga e cila mund të vërtetohet se është fjala për transportin e mallrave për nevoja vetanake.
2. Mjetet me të cilat kryhet ky lloj transporti duhet të ngasin shoferët të punësuar tek personi juridik apo fizik ose vet personi fizik
3. Mjetet duhet të jenë në pronësi të personit fizik apo juridik dhe të pajisur me certifikatë të mjetit.

## Neni 61

### Transporti i mallrave me qira dhe pagesë

1. Transporti i mallrave me qira dhe pagesë (për palë të tretë) kryhet në bazë të marrëveshjes me shkrim ose me gojë në mes të dërguesit dhe marrësit të mallit i cili kontraktin transportin e mallrave.
2. Gjatë transportit të mallrave me qira dhe pagesë, operatori i transportit në automjet mbi 3,5 tonelata të një mase më të madhe të lejuar, në automjet duhet të ketë:
  - 2.1. fletëngarkesën dhe
  - 2.2 kontratën në mes të qiramarrësit dhe qiradhënësit.
3. Mjetet me të cilat kryhet ky lloj transporti duhet të ngasin shoferët të punësuar tek personi juridik apo fizik ose vet personi fizik
4. Mjetet duhet të jenë në pronësi të personit fizik apo juridik dhe të pajisur me certifikatë të mjetit.

## Neni 62

### Transporti i mallrave për bartjen e mjeteve (shërbimi "Merimangë")

1. Transporti i mallrave për bartjen e mjeteve (shërbimi "Merimangë") nënkupton tërheqjen – bartjen e automjeteve të marruar ku është ndaluar qëndrimi i tyre nga vendet ku ka ndodhur aksidenti i komunikacionit, ose që mund të jenë të braktisura dhe në raste të tjera vendosja e tyre për këtë qëllim.
2. Komuna do të lidhë kontratë me operatorin e transportit me (shërbim "Merimangë") me përfituesin e tenderit me të cilin do të përcaktohen të drejtat, kushtet dhe detyrimet e palëve kontraktuese, si: Vendin - lokacionin për vendosjen e automjeteve, mënyrën e organizimit të bartjes dhe gjendjes së mjetit, kohën e caktuar të kontratës, çmimin për shërbim, mënyra e lirimit të mjetit me dëshmi të pagesës dhe mënyrën e hapjes së ankandit publik për shitjen e mjeteve, të cilat përcaktohen nga DESHP-së - Komuna e Kaçanikut.
3. Gjatë transportit për bartjen e mjeteve (shërbimi i transportit me "merimangë") operatori i transportit në automjet duhet të ketë:
  - 3.1. fletëngarkesën dhe
  - 3.2 kontratën për kryerjen e këtij shërbimi.
4. Mjetet me të cilat kryhet ky lloj transporti duhet të ngasin shoferët të punësuar tek personi juridik apo fizik ose vet personi fizik.
5. Mjetet duhet të jenë në pronësi të personit fizik apo juridik dhe të pajisur me certifikatë të mjetit.

## Neni 63

### Mbikqyrja dhe kontrolli

1. Mbikqyrjen e zbatimit të dispozitave të kësaj rregulloreje e bën Inspeksioni i komunikacionit rrugor dhe Policia e Kosovës.
2. Operatori i transportit rrugor është i detyruar t'i paraqes inspektorit tërë dokumentacionin e kërkuar dhe t'i krijoj atij të gjitha lehtësitë për ushtrimin e kompetencave sipas kësaj rregulloreje dhe ligjeve në fuqi.
3. Inspeksioni i komunikacionit rrugor është i autorizuar:
  - 3.1 Të bëjë kontrollin e operatorëve të transportit rrugor se a janë duke ushtruar veprimtarinë e vet në pajtim me dispozitat e kësaj Rregulloreje dhe Ligjeve në fuqi,
  - 3.2 Të urdhëroj mënjanimin e lëshimeve dhe mangësive në aspektin e plotësimit të kushteve të përcaktuara me këtë Rregullore dhe Ligjeve në fuqi, për kryerjen e transportit të udhëtarëve dhe të mallrave,

3.3 Të përjashtoj nga qarkullimi automjetin me të cilin kryhet transporti në kundërshtim me dispozitat e ligjit dhe të kësaj Rregulloreje të caktoj vendparkimin, të marr lejen e qarkullimit dhe targat në kohëzgjatje prej 48 orësh.

4. Nëse të njëjtit operator të transportit i shqiptohet masa e dënimit për herë të dytë, për shkaqet e përcaktuara në paragrafin 3 pika 3.3 të këtij neni, automjeti do të përjashtohet nga qarkullimi, në kohëzgjatje deri në 5 ditë.

5. Me rastin e përjashtimit të automjetit taksi, i merret shenja “TAXI” - “RADIO TAXI”, targat e regjistrimit, çertifikata e regjistrimit të automjetit.

6. Me kalimin e afatit të shqiptimit të dënimit, nga paragrafi 3 pika 3.3 dhe paragrafi 4 i këtij neni, inspektori ia kthen operatorit dokumentet dhe targat e marra, qoftë vet apo përmes organit i cili ka lëshuar këto.

#### **Neni 64**

1. Inspektori i komunikacionit rrugor dhe policia e Kosovës, në kuadër të autorizimeve të tyre, shqipton gjoba mandatore dhe bën fletparaqitje për inicimin e procedurës kundërvajtëse pranë Gjykatës Themelore në Ferizaj – Dega në Kaçanik, për kundërvajtje kundër atyre të cilët veprojnë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe ligjeve në fuqi.

2. Inspektori i komunikacionit rrugor, bën kërkesa, njoftime, urdhëresa dhe vendime në funksion të zbatimit të kësaj rregulloreje si dhe inicon procedurë përmbartimore.

#### **Neni 65**

Kur inspektori përjashton automjetin nga qarkullimi, merr vendim që automjeti i ndaluar të dërgohet në shpenzime të mbajtësit të licencës, në vende të caktuara për këto raste.

#### **Neni 66**

1. Kundër vendimit të inspektorit komunal të komunikacionit rrugor, mund t'i ushtrohet ankesa në komisionin komunal të ankesave, në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së vendimit.

2. Ankesa dërgohet përmes organit komunal kompetent.

3. Ankesa nuk e shtyn ekzekutimin e vendimit.

#### **Neni 67**

##### **Dispozitat ndëshkimore**

1. Për kundërvajtje me gjobë prej 150 € deri në 3000 €, do të dënohet operatori transportues, përkatësisht personi juridik dhe personi përgjegjës i personit juridik apo fizik për kundërvajtje, nëse:

1.1 Ushtron veprimtarinë e transportit publik urban dhe urbano – periferik pa licencë – leje pune (neni 8),

1.2 ushtron veprimtarinë e transportit publik të udhëtarëve në kundërshtim me nenin 9, dhe 10,

1.3 Vepron në kundërshtim me nenin 11, nenin 17 paragr. 6, neni 18.

#### **Neni 68**

1. Për kundërvajtje me gjobë prej 500 € deri në 1000 €, do të dënohet operatori transportues, përkatësisht personi juridik dhe personi përgjegjës i personit juridik apo personi fizik nëse:

1.1. Vepron në kundërshtim me nenin 63.

#### **Neni 69**

1. Me gjobë prej 150 € deri në 1000 € do të dënohet operatori i transportues, përkatësisht personi juridik dhe personi përgjegjës i personit juridik dhe personi fizik, në qoftë se:

1.1. Vepron në kundërshtim me nenin 7, nenin 12, 16, 17, 18 si dhe nenet 20, 21, 22, 23, 24.

#### **Neni 70**

1.1. Me gjobë prej 150 € deri në 1500 € dënohet për kundërvajtje operatori i transportit, përkatësisht personi juridik dhe

1.2. Me gjobë prej 100 € deri 500 € dënohet për kundërvajtje personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse:

2. Vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 25 pika 1.2, paragrafi 2), pika 2.2; 2.3; 2.4; paragrafet 4, 5, 6, 7, 8 dhe nenet 27, 28, 36, 37, neni 38 paragrafi 1) pikat 1.3; 1.4; 1.5; 1.6; 1.9; paragrafi 2) si dhe nenet 42, 47, 49, 50, 51, 52, 53.

#### **Neni 71**

1.1. Me gjobë prej 150 € deri në 2500 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit përkatësisht personi juridik dhe

1.2. Me gjobë prej 100 € deri 600 € dënohet për kundërvajtje personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse:

2. Vepron në kundërshtim me neni 29, 30, 32, 39, 46, 55.

#### **Neni 72**

1.1. Me gjobë prej 150 € deri në 3000 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit përkatësisht personi juridik dhe

1.2. Me gjobë prej 100 € deri 700 € dënohet për kundërvajtje personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse:

2. Vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 26, 40, 48, 54, 58, 59.

#### **Neni 73**

1.1. Me gjobë prej 200 € deri në 3500 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit përkatësisht personi juridik dhe

1.2. Me gjobë prej 100 € deri 800 € dënohet për kundërvajtje personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse:

2. Vepron në kundërshtim me dispozitat e nenet 33, 34, 35, 38 paragrafi 1) pikat 1.1; 1.2; 1.7; 1.8; 1.10; 1.11; 1.12; 1.13 si dhe nenet 56, 60, 61, 62.

#### **Neni 74**

1.1. Me gjobë prej 300 € deri në 4000 € do të dënohet për kundërvajtje operatori i transportit përkatësisht personi juridik dhe

1.2. Me gjobë prej 100 € deri 900 € dënohet për kundërvajtje personi fizik dhe personi përgjegjës i personit juridik, nëse:

2. Vepron në kundërshtim me dispozitat e nenit 25 pika 1.1; 1.3; 1.4; paragrafi 2) pika 2.1; 2.5, paragrafi 3), si dhe nenet 41, 43, 44, 45.

#### **Neni 75**

1. Dënimet mandatore për kundërvajtje në shumë deri në 1000 (njëmijë) € i shqipton Inspektori i Komunikacionit.

2. Në rast se subjekti i mbikëqyrur, nuk bën ekzekutimin e gjobës brenda afatit të dhënë me aktvendim, inspektori mund të inicioj procedurë kundërvajtëse në gjyketën kompetente ose të bëjë iniciimin e procedurës përbarimore, brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) deri në (90) ditësh nga dita kur aktvendimi të bëhet i plotfuqishëm.

#### **Neni 76**

#### **Dispozitat kalimtare dhe përfundimtare**

Obligohen operatorët e transportit rrugor, që në afat prej 6 muajsh prej ditës së hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të bëjnë harmonizimin e akteve të tyre me dispozitat e kësaj Rregulloreje.

#### **Neni 77**

Nëse operatori i transportit, përkatësisht personi fizik apo juridik bën përsëritje të kundërvajtjes së njejtë, atëherë përpos dënimit me gjobë, do ti shqiptohet edhe masa mbrojtëse e ndalesës për ushtrimin e veprimtarisë së transportit rrugor në kohëzgjatje prej 6 deri 12 muaj.

#### **Neni 78**

1. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja 01 Nr. 07-344-32032/14 e datës 31.10.2014 dhe Rregullorja 01Nr.07-104/02-13623/25 e datës 30.06.2025 Për Transport Rrugor në Territorin e Komunës së Kaçanikut.

#### **Neni 79**

Për të gjitha rastet që nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohet ligji për transport rrugor.

#### **Neni 80**

#### **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, përkatësisht 7 ditë pas publikimit në ueb-faqen e komunës dhe në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

